

VENDIM
Nr. 497, datë 30.7.2021

**PËR MIRATIMIN E KLAUZOLAVE TË STABILITETIT PËR KONTRATËN E
KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PËR DHËNIEN ME
KONCESION/PPP TË PORTIT TË JAHTEVE “MARINA RODON”, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE
EKONOMIKË “PRASLIN INVESTMENT” SHPK DHE “R&T” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e klauzolave të stabilitetit për kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënie me koncesion/PPP të portit të jahteve “Marina Rodon”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Praslin Investment” sh.p.k. dhe “R&T” sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe